

37999



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANE

Nr. 37999/Vendimi.

Tirane, me 12.04.2007

V E N D I M :

PER REGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

Sot me daten 12.04.2007 (dymijeeshtate), une Gjyqtare e Rrethit Gjyqesor Tirane M. Shegani (bedi), mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga Zoti Veledin Spiro IDRIZAJ per themelimin e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar te emertuar "EUROCLIMA" Shpk si Person Juridik:

K O N S T A T O V A :

Kerkuesi: Veledin Spiro IDRIZAJ, me cilesine e Ortakut te vetem themelues, ne baze te Aktit te Themelimit e te Statutit te perpiluar prej tij posacerisht ka krijuar Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar "EUROCLIMA" Shpk.

"EUROCLIMA" Shpk ka per Objekt:

Ushtrimin e tregetise me shumice e pakice te artikujve te ndryshem industriale, paisje e materiale te ndryshme hidraulike e elektrike, dhe ne pergjithesi cdo aktivitet plotesues.

Import dhe eksport mallra e paisje te te gjitha llojeve, makineri e paisje, si dhe aktivitetin e shperndarjes e te perdorimit te tyre, per vete Shoqerine dhe per te tjere.

Te kryeje furnizime te impianteve dhe te paisjeve teknike per aktivitete qe operojne dhe qe kane lidhje me ato te shoqerise.

Shoqeria mund te kryej te gjitha operacionet industriale, tregtare, prodhuese, ndertuese, ndertime objekte te ndryshme industriale e civile, prodhime inertesh e materiale ndertimi, financime, qe Administratori e quan te nevojshem per arritjen e qellimit te shoqerise, si dhe cdo veprimtari tjeter qe nuk bie ne kundersiztim me ligjin.

Shqeria do te kryej veprimtari ne fushen hotelerise, turizmit, ushqimit social, administrim i internet cafese, perfshire administrimin e aktiviteteve te lidhura me te si bar - kafe, sherbime fotokopje, shitje te vogla kancelerie dhe materiale te konsumit e aktivitete te tjera te ketij lloji.

Te hyje ne veprimtari afariste qe cojne ne realizimin e synimeve te saj.

Shoqeria mund te kryej drejtperdrejt apo indirekt, brenda dispozitave ligjore, pjesemarrje ne Shoqeri te tjera, te zhvilloje cdo lloj aktiviteti, qe lidhet dhe ne menyre indirekte me qellimet e Shoqerise e qe vleresohen te dobishme per arritjen e tyre.

Për këtë qëllim shoqëria ka të drejtë:
Të importojë, eksportoje dhe tregtojë makineri dhe pajisje e produkte te ndryshme industriale e bujqesore.

Ti japë punë me porosi te tretëve për shërbime të ndryshme.

Te ofroje dhe te kryej shërbime e konsulenca ne fushen teknike dhe tregtare.

Të organizojë kurse formimi dhe specializimi.

Shoqëria ka seline e saj ne Bërxulle, Tirane.

Qendra fiskale e shoqërine, është selia e shoqërise.

Kohezgjatja e Shoqërise është pa afat.

Kapitali themeltar i Shoqërise është 100.000 (njqindmije) leke, i ndare ne 100 (njqind) kuota, me nje vlere 1000 lek secila, me numer serie nga 1 deri ne 100.

Derdhja e kuotave është bere totalisht nga Ortaku i vetem themelues i Shoqërise Zoti Veledin Spiro IDRIZAJ ne masen 100.000 (Njqindemije) Lek, qe i perkasin 100 kuota, nga Nr.1 deri Nr.100 te serise, e qe korespondojne me 100 % te kapitalit te shoqërise.

Administrator i Shoqërise "EUROCLIMA" Shpk është Zoti Veledin Spiro IDRIZAJ.

Kerkesa e paraqitur ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tirane nga Zoti Veledin Spiro IDRIZAJ per regjistrim si Person Juridik te Shoqërise "EUROCLIMA" Shpk është e drejte dhe e bazuar ne Ligj.

PER KETO ARSYE :

Ne baze te ligjit Nr.7512 date 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, te nismes se lire, te veprimtarise private te pavarur dhe privatizimit" dhe ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqërite tregtare", si dhe nenit 64 te ligjit 7667 date 28.01.1993 per regjistrimin e shoqërive ne Regjistrin Tregtar.

V E N D O S A :

Pranimin e kerkeses.

Regjistrimin si Person Juridik te Shoqërise "EUROCLIMA" Shpk.

Objekti i Shoqërise "EUROCLIMA" Shpk do te jete:

Ushtrimin e tregëtise me shumice e pakice te artikujve te ndryshem industriale, paisje e materiale te ndryshme hidraulike e elektrike, dhe ne pergjithesi cdo aktivitet plotesues.

Import dhe eksport mallra e paisje te te gjitha llojeve, makineri e paisje, si dhe aktivitetin e shperndarjes e te perdorimit te tyre, per vete Shoqërine dhe per te tjere.

Te kryeje furnizime te impianteve dhe te paisjeve teknike per aktivitete qe operojne dhe qe kane lidhje me ato te shoqërise.

Shoqëria mund te kryej te gjitha operacionet industriale, tregtare, prodhuese, ndertuese, ndertime objekte te ndryshme industriale e civile, prodhime inertesh e materiale ndertimi, financime, qe Administratori e quan te nevojshem per arritjen e qellimit te shoqërise, si dhe cdo veprimtari tjeter qe nuk bie ne kundërshtim me ligjin.

Shqëria do të kryej veprimtari në fushën hotelerisë, turizmit, ushqimit social, administrim i internet kafesë, përfshirë administrimin e aktiviteteve të lidhura me të si bar -kafë, shërbime fotokopje, shitje të vogla kancelarie dhe materiale të konsumit e aktivitete të tjera të këtij lloji.

Te hyjë në veprimtari afariste që çojnë në realizimin e synimeve të saj. Shqëria mund të kryej drejtpërdrejt apo indirekt, brenda dispozitave ligjore, pjesëmarrje në Shoqëri të tjera, të zhvillojë çdo lloj aktiviteti, që lidhet dhe në mënyrë indirekte me qëllimet e Shoqërisë e që vlerësohen të dobishme për arritjen e tyre.

Për këtë qëllim shoqëria ka të drejtë:

Të importojë, eksportojë dhe tregtojë makineri dhe pajisje e produkte të ndryshme industriale e bujqësore.

Ti japë punë me porosi të tretëve për shërbime të ndryshme.

Te ofrojë dhe të kryej shërbime e konsulenca në fushën teknike dhe tregtare.

Të organizojë kurse formimi dhe specializimi.

Shqëria ka selinë e saj në Bërxullë, Tiranë.

Qendra fiskale e shoqërisë, është selia e shoqërisë.

Kohezgjatja e Shoqërisë është pa afat.


Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 (njqindmijë) lekë, i ndarë në 100 (njqind) kuota, me një vlerë 1000 lekë secila, me numër serie nga 1 deri në 100.

Derdhja e kuotave është bërë totalisht nga Ortaku i vetëm themelues i Shoqërisë Zoti Vëledin Spiro IDRIZAJ në masën 100.000 (Njqindmijë) Lekë, që i perkasin 100 kuota, nga Nr.1 deri Nr.100 të serisë, e që korespondojnë me 100 % të kapitalit të shoqërisë.

Administrator i Shoqërisë "EUROCLIMA" Shpk është Zoti Vëledin Spiro IDRIZAJ.

Kunder këtij Vendimi lejohet ankimi.

GJYQTARE

Mariana Shëgani (Bedi)


37 PPP

URDHER REGJISTRIMI

I	Nr. regjistrimi
II	<p>A. Emri "EUROCLIMA", Sh.p.k</p> <p>B. Selia Bërçulli; TIRANE</p> <p>C. Objekti Tregtimit shumicë e pakicë të artikujve të ndryshëm industrialë, pajisje e materiale të ndryshme mekanike e elektrike dhe në përgjithësi ato aktivitet plotësues; Operacione Industriale; përgatitje ndërtimesh, hoteleri, turizëm, veprimtari afaniste, pjesëmarrje në shopen të heta etj.</p> <p>D. Kapitali 100.000 (njëqind mijë) lekë i derollur 100% nga artet e vjetër të V. Spiros Tërbizgj.</p>
III	Administratori VELEDIN SPIRO IDRIZAJ i dtit 20/03/1968. SW Kuz. vlorë dhe bames në Bërçull Tiranë.
IV	<p>Kohezgjatja PA AFAT</p> <p>Akt - Themelimi 4 fletë + 1N</p> <p>Statuti 12 fletë + 1N</p> <p>} 05/04/2007.</p>
V	<p>Nenshkrimi \</p> <p>Statuti 04.04.2007</p> <p>Akt- Themelimi 04.04.2007</p> <p>} 12/04/2007.</p>

Proses verbal depozitimi kapitali tek noteri Boris Skenderi nr. 1273 Rep. dt. 05.04.2007 dhe mandat ardhje nr. 8 dt. 05.04.2007

GJYQTARE

MARIANA SHEGANI (DEDI)



AKT - THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"EUROCLIMA" Shpk

EMERTIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISE, SELIA, KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Ne baze te Ligjeve ne Republikën e Shqipërisë:

-Nr.7512 date 10.08.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, veprimtarive private, të pavarura dhe privatizimit.

-Nr.7638 datë 19.11.1992 "Per shoqërite tregtare".

-Nr.7667 datë 28.1.1993 "Per rregjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare".

-Nr.7764 date 2.11.1993 "Mbi investimet e huaja".

Me vullnetin tim te lire jam shprehur ne nenshkrimin e ketij Akti Themelimi si ortak i vetem themelues:

Veledin IDRIZAJ, i biri i Spiros dhe i Hamidese, me kombesi e shtetesi Shqipetare, lindur me 20.03.1968 ne Kuc, Vlore dhe me banim: ne Bexulle, Tirane, identifikuar nepermjet Pasaportes Nr.1430030 date 02.09.1999, madhor, me zotesi te plote juridike perte vepruar.

Deklaroj se kam perpiluar si me poshte vijon Aktin e Themelimit te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar te emertuar "EUROCLIMA" Shpk.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Ushtrimin e tregetise me shumice e pakice te artikujve te ndryshem industriale, paisje e materiale te ndryshme hidraulike e elektrike, dhe ne pergjithesi cdo aktivitet plotesues.

Import dhe eksport mallra e paisje te te gjitha llojeve, makineri e paisje, si dhe aktivitetin e shperndarjes e te perdorimit te tyre, per vete Shoqerine dhe per te tjere.

Te kryeje furnizime te impianteve dhe te paisjeve teknike per aktivitete qe operojne dhe qe kane lidhje me ato te shoqerise.

Shoqeria mund te kryej te gjitha operacionet industriale, tregtare, prodhuese, ndertuese, ndertime objekte te ndryshme industriale e civile, prodhime inertesh e materiale ndertimi, financime, qe Administratori e quan te nevojshem per arritjen e qellimit te shoqerise, si dhe cdo veprimtari tjetër qe nuk bie ne kundërshtim me ligjin.

Shqeria do te kryej veprimtari ne fushen hotelerise, turizmit, ushqimit social, administrim i internet cafese, perfshire administrimin e aktiviteteve te lidhura me te si bar -kafe, sherbime fotokopje, shitje te vogla kancelerie dhe materiale te konsumit e aktivitete te tjera te ketij lloji.

Te hyje ne veprimtari afariste qe cojne ne realizimin e synimeve te saj.
Shoqeria mund te kryej drejtperdrejt apo indirekt, brenda dispozitave ligjore, pjesemarrje ne Shoqeri te tjera, te zhvillojë cdo lloj aktiviteti, qe lidhet dhe në mënyrë indirekte me qëllimet e Shoqërisë e qe vlerësohen të dobishme për arritjen e tyre.

Për këtë qëllim shoqëria ka të drejtë:

Të importojë, eksportojë dhe tregtojë makineri dhe pajisje e produkte te ndryshme industriale e bujqesore.

Ti japë punë me porosi te tretëve për shërbime të ndryshme.

Te ofrojë dhe te kryej shërbime e konsulenca ne fushen teknike dhe tregtare.

Të organizojë kurse formimi dhe specializimi.

SELIA

Shoqeria ka seline e saj ne Berxulle, Tirane.

Keshilli Administrativ mund te krijojë, modifikojë apo anullojë seli sekondare, agjensi dhe perfaqesi kudo qe e quan te nevojshme, edhe jashte shtetit.

Qendra fiskale e ortakeve, persa u perket raporteve te tyre me shoqerine, eshte selia e shoqerise.

KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e Shoqerise eshte pa afat.

Mund te zgjatet, si dhe te zgjidhet perpara kohe me miratim te Asamblese se Jashtezakonshme.

KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100.000 (njqindmije) leke, i ndare ne 100 (njqind) kuota, me nje vlere 1000 lek secila, me numer serie nga 1 deri ne 100.

Fondet qe vijne nga derdhjet depozitohen ne nje nga Bankat Shqiptare ne Tirane ne nje llogari ne emer te shoqerise.

KUOTAT E DERDHURA

Derdhja e kuotave eshte bere totalisht nga Ortaku i vetem themelues i Shoqerise Zoti Vledin Spiro IDRIZAJ ne masen 100.000 (Njqindemije) Lek, qe i perkasin 100 kuota, nga Nr.1 deri Nr.100 te serise, qe korespondojne me 100 % te kapitalit te shoqerise.

Shumat e derdhura ne para mund te kreditohen ne llogari bankare ne emer te shoqerise ne Bankat e ndryshme qe zhvillojne aktivitetin e tyre ne Republiken e Shqiperise, por edhe jashte shtetit.

Administrator i Shoqerise "EUROCLIMA" Shpk eshte Zoti Vledin Spiro IDRIZAJ.

Shoqeria mund te ndyshoje pjesemarrjen ne kapitalin e Shoqerise me Vendim te Ortakut te vetem themelues, dhe ne funksion te tij dhe administrimi i Shoqerise.



Kompetencat e administratorit ndaj ortakeve do te percaktohen ne dokumentet themelore; ne Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqerise.

Aktiviteti i shoqerise mbyllet me 31 dhjetor te cdo viti dhe bilanci duhet aprovuar brenda 31 Marsit te vitit pasardhes nga Ortaket e shoqerise.

Per te ndjekur aktivitetin e Shoqerise ne vijimesi, Administratori i Shoqerise se bashku me shefin e finances e kontabilitetit do t'i paraqesin Ortaket/ye bilancin cdo 3/mujor brenda dates 15 te muajit te pare te tremujorit pasardhes.

Shoqeria e fillon aktivitetin ne momentin e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar prane Gjykates se Rrethit Gjyqsor Tirane.

ORGANET E SHOQERISE

Organet e Shoqerise jane:

-Asambleja e Ortakeve

-Administratori

Asambleja e Ortakeve eshte organi me i larte i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar e "EUROCLIMA" Shpk.

Te drejtat e Ortakeve ne kete Akt - Themelimi jane si vijon:

- Te marrin pjese ne administrimin dhe drejtimin e shoqerise.
- Te marrin pjese ne ndarjen e fitimit sipas pjesmarrjes se kapitalit, ne perputhje me statutin.
- Ne baze te kuotave te kapitalit qe kane, te marrin pjese ne shperndarjen e aktivitet qe do te rezultojne mbas daljes se bilancit te likuidimit, ne rast se mbyllet shoqeria.

Detyrimet e Ortakeve ne kete Akt-Themelimi jane si vijon:

- Te derdhen pjesen e kapitalit baze, sikurse parashikohet ne kapitalin fillestar te kesaj shoqerise.
- Te marrin pjese ne drejtimin dhe administrimin e shoqerise ne perputhje me statutin.
- Te ruajne sekretin per gjithcka qe ka te beje me aktivitetin e shoqerise.
- Ortaket kane te drejte te heqin dore prej ketij Akt - Themelimi, sipas normave te Statutit.

Modifikime te mundshme apo shtesa ne kete Akt - Themelimi, do te kene vlere dhe do te zbatohen vetem ne rast se paraqiten me shkrim te firmosura nga Ortaket, ose po qe nevoja, te shoqeruara me autorizimet perkatese te instancave kompetente.

Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen me ane te kontrates se punes.

Per ceshtjet qe nuk rregullohen me kontraten e punes, zbatohen dispozitat e Kodit te Punes.

Kjo eshte e njejte edhe per filialet, zyrat e perfaqesimit apo agjensite.

NE FUND:

Dispozita me te hollesishme mbi organizimin e kasaj Shoqerise percaktohen ne Statutin e saj.

Ortaku i vetem themelues i Shoqerise "EUROCLIMA" Shpk pasi e lexoi me vemendje aktin e mesiperm dhe e gjen ate konform vullnetit te tij, e firmos rregullisht.

ORTAKU I VETEM THEMELUES I SHOERISE
"EUROCLIMA" Shpk



Tirane, me 04.04.2007

Veledin Spiro IDRIZAJ

Veledin Idrizaj

A handwritten signature in black ink, appearing to be 'V. Idrizaj', written below the printed name.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
DHOMA E NOTEREVE
TIRANE




Nr. 1271 Rep. Nr. 129.Kol.
Tirane, me 05.04.2007

VERTETIM:

Ne Tirane, sot me daten 05.04.2007 (dymijeeshtate), para meje Noterit Publik Boris M.SKENDI, me Seli Rruga "Reshit COLLAKU", Pall. "Shallvareve", Nr.4 Tirane, u paraqit personalisht dhe me kerkoi vertetimin noterial te nenshkrimit te tij ne kete Akt Themelimi, perpiluar jashte kesaj Zyre Noteriale, per themelimin e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "EUROCLIMA" Shpk.

Veledin IDRIZAJ, i biri i Spiros dhe i Hamidese, me kombesi e shtetesi Shqiptare, lindur me 20.03.1968 ne Kuc, Vlore dhe me banim: ne Bexulle, Tirane, identifikuar nepermjet Pasaportes Nr.1430030 date 02.09.1999, madhor, me zotesi te plote juridike perte vepruar.

Sa me lart mbasi u binda per identitetet e tij nepermjet dokumenteve individuale qe mban me vete si dhe per nenshkrimin e vullnetshem sipas deklarimit te tij ne kete Zyre Noteriale, me pas une Noteri Publik e vertetoj ate sipas kompetencave qe me jep Ligji Nr.7829 date 01.06.1994 "Per Noterine".





STATUTI

I

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "EUROCLIMA" Shpk

Ne baze te Ligjeve ne Republikën e Shqipërisë:

-Nr.7512 date 10.08.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, veprimtarive private, të pavarura dhe privatizimit.

-Nr.7638 datë 19.11.1992 "Per shoqërite tregtare".

-Nr.7667 datë 28.1.1993 "Per rregjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare".

-Nr.7764 date 2.11.1993 "Mbi investimet e huaja".

Me vullnetin tim te lire une ortaku i vetem themelues Veledin Spiros IDRIZAJ, me kombesi e shtetesi Shqiptare, lindur me 20.03.1968 ne Kuc, Vlore dhe me banim: ne Berxulle, Tirane, identifikuar nepermjet Pasaportes Nr.1430030 date 02.09.1999; jam shprehur me nenshkrimin e ketij Statuti per krijimin e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "EUROCLIMA" Shpk sipas ligjeve shqiptare ne fuqi.

KAPITULLI I

FORMA, EMERTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHEZGJATJA

NENI 1

FORMA

Shoqeria "EUROCLIMA" Shpk eshte krijuar ne formen e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar dhe rregullohet nga Akti i Themelimit e Statuti i perpiluar posacerisht.

Shoqeria vepron sipas ligjit shqiptar ne fuqi, vecanerisht, duke iu referuar Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", Nr.7764 date 2.11.1993 "Mbi investimet e huaja", dhe ligjeve te tjera qe do te emetohen gjate periudhes se aktivitetit te shoqerise.

Akti i themelimit dhe Statuti jane konform normativave shqiptare ne menyre te pashmangshme dhe jane pjese perberese e ligjit shqiptar.

Shoqeria merr personalitet juridik shqiptar nga dita e regjistrimit te saj ne zyren e Regjistrimit Tregtar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqsor Tiranes.

NENI 2
EMERTIMI

Themelohet nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "EUROCLIMA" Shpk.

NENI 3
OBJEKTI

Ushtrimin e tregetise me shumice e pakice te artikujve te ndryshem industriale, paisje e materiale te ndryshme hidraulike e elektrike, dhe ne pergjithesi cdo aktivitet plotesues.

Import dhe eksport mallra e paisje te te gjitha llojeve, makineri e paisje, si dhe aktivitetin e shperndarjes e te pedorimit te tyre, per vete Shoqerine dhe per te tjere.

Te kryeje furnizime te impianteve dhe te paisjeve teknike per aktivitete qe operojne e qe kane lidhje me ato te shoqerise.

Shoqeria mund te kryej te gjitha operacionet industriale, tregtare, prodhuese, ndertuese, ndertime objekte te ndryshme industriale e civile, prodhime inertesh e materiale ndertimi, financime, qe jane te nevojshme per arritjen e qellimit te shoqerise, si dhe cdo objekt tjeter qe nuk bie ne kundershtrim me ligjin.

Shqeria do te kryej veprimatri ne fushen hotelerise, turizmit, ushqimit social, administrim i internet cafese, perfshire administrimin e aktiviteteve te lidhura me te si: bar, sherbime fotokopje, shitje te vogla kancelerie dhe materialeve te konsumit e aktivitete te tjera te ketij lloji.

Te hyje ne veprimtari afariste qe con ne realizimin e synimeve te saj.

Shoqeria mund te kryej drejtperdrejt apo indirekt, brenda dispozitave ligjore, pjesemarrje ne Shoqeri te tjera, te zhvilloje cdo lloj aktiviteti, qe lidhet dhe ne menyre indirekte me qellimet e Shoqerise e qe vleresohen te dobishme per arritjen e tyre.

Për këtë qëllim shoqëria ka të drejtë:

Të importojë, eksportoje dhe tregtojë makineri dhe pajisje e produkte te ndryshme industriale e bujqesore.

Ti japë punë me porosi te tretëve për sherbime të ndryshme.

Te ofroje dhe te kryeje sherbime e konsulenca ne fushen teknike dhe tregtare.

Të organizojë kurse formimi dhe specializimi.

NENI 3.1
SELIA

Ushtrimin e tregetise me shumice e pakice te artikujve te ndryshem industriale, paisje e materiale te ndryshme hidraulike e elektrike, dhe ne pergjithesi cdo aktivitet plotesues.

Import dhe eksport mallra e paisje te te gjitha llojeve, makineri e paisje, si dhe aktivitetin e shperndarjes e te pedorimit te tyre, per vete Shoqerine dhe per te tjere.

Te kryeje furnizime te impianteve dhe te paisjeve teknike per aktivitete qe operojne dhe qe kane lidhje me ato te shoqerise.

Shoqeria mund te kryej te gjitha operacionet industriale, tregtare, prodhuese, ndertuese, ndertime objekte te ndryshme industriale e civile, prodhime inertesh e materiale ndertimi, financime, qe Administratori e quan te nevojshem per arritjen e qellimit te shoqerise, si dhe cdo objekt tjetër qe nuk bie ne kundërshtim me ligjin.

Shoqeria do te kryej veprimtari ne fushen hotelerise, turizemit, ushqimit social, administrim i internet cafese, perfshire administrimin e aktiviteteve te lidhura me te si: bar, sherbime fotokopje, shitje te vogla kancelerie dhe materialeve te konsumit e aktivitete te tjera te ketij lloji.

Te hyje ne veprimtari afariste qe con ne realizimin e synimeve te saj.

Shoqeria mund te kryej drejtperdrejt apo indirekt, brenda dispozitave ligjore, pjesemarrje ne Shoqeri te tjera, te zhvillojë cdo lloj aktiviteti, qe lidhet dhe ne menyre indirekte me qellimet e Shoqerise e qe vleresohen te dobishme per arritjen e tyre.

Për këtë qëllim shoqëria ka të drejtë:

Të importojë, eksportojë dhe tregtojë makineri dhe pajisje.

Ti japë punë me porosi te tretëve për sherbime të ndryshme.

Te ofroje sherbime e konsulenca ne fushen teknike dhe tregtare.

Të organizojë kurse formimi dhe specializimi.

NENI 4

KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e Shoqerise eshte pa afat.

Mund te zgjatet, si dhe te zgjidhet perpara kohe me miratim te Asamblese se Jashtezakonshme.

KAPITULLI II

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 5

KAPITALI

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100.000 (njqindmije) leke, i ndare ne 100 (njqind) kuota, me nje vlere 1000 lek secila, me numer serie nga 1 deri ne 100.

Fondet qe vijne nga derdhjet depozitohen ne nje nga Bankat Shqiptare ne Tirane ne nje llogari ne emer te shoqerise.

NENI 6

KUOTAT E DERDHURA

Derdhja e kuotave eshte bere totalisht nga Ortaku i vetem themelues i Shoqerise Zoti Vledin Spiro IDRIZAJ ne masen 100.000 (Njqindemije) Lek, qe i perkasin 100 kuota, nga Nr.1 deri Nr.100 te serise, qe korespondojne me 100 % te kapitalit te shoqerise.

Shumat e derdhura ne para mund te kreditohen ne llogari bankare ne emer te shoqerise ne Bankat e Ndryshme qe zhvillojne aktivitetin e tyre ne Republiken e Shqiperise, por edhe jashte shtetit.

NENI 7
E DREJTA E PARAZGJEDHJES

Shoqeria "EUROCLIMA" Shpk me Vendim te Ortakeve themelues mund te ndryshoje pjesmarrjen ne kapitalin e shoqerise me dy e me shume Ortake.

Gjithashtu:

Ortaku qe ka ndermend te shese kuotat e tij, duhet te informoje me leter rekomande (duke permbajtur cmimin e shitjes) Organin Administrativ, i cili do ti komunikojte menjehere tek te gjitha ortaket e tjere.

Cmimi i kuotave oferte per shitje duhet te vendoset ne baze te vleres reale te Shoqerise ne momentin e dhenies se te drejtes.

Ortaket e tjere mund te behen bleres te kuotave oferte per shitje, ne raport me kuotat qe posedojne secili, ne menyre qe te mbetet i palevizshem raporti paraprak i pjesemarrjes ne shoqeri.

Ne cdo rast, brenda 30 diteve nga dita qe eshte bere komunikimi, ortaket duhet t'i komunikojne Organit Administrativ nese duan t'i blejne; ne mungese te komunikimit ne perfundim te afatit, ata konsiderohen qe heqin dore.

Nese nje apo disa ortake heqin dore nga blerja, kuota oferte per shitje mund te blihet nga ortaket e tjere (qofte edhe nje) qe kane komunikuar se duan t'i blejne, duke ndryshuar ne kete menyre raportet e pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerise.

Nese asnje ortak nuk ushtron te drejten e zgjedhjes sipas menyres se treguar, kuota eshte lirisht e transferueshme.

NENI 8
FINANCIMI NGA ANA E ORTAKEVE

Ortaket mund te sjellin ne shoqeri shuma ne tituj financimi, mjafton te jene konform normave ne fuqi.

Keto financime fakultative mund te mos jene ne menyre proporcionale sipas kuotave qe zoterojne, dhe presupozohet pa interes, pervec rasteve kur Asambleja vendos ndryshe.

NENI 9
RRITJE TE KAPITALIT THEMELTAR

Kapitali themeltar mund te rritet pa kufizim ne cdo moment dhe nje apo disa here me votim te Asamblese se Jashtezakonshme te ortakeve votues prezent apo perfaqesues qe permbajne te pakten 3/4 e kapitalit themeltar.

Ne rast te shqyrtimit te rritjes se kapitalit, ortaku i vetem ose (ortaket) kane te drejte te nenshkruajne rritjen sipas kuotave qe posedojne.

Ne rast se nuk e ushtrojne kete te drejte, kuotat e tyre mund te nenshkruhen nga ortaket e tjere ne menyre proporcionale sipas pjesemarrjeve perkatese.



NENI 10

REDUKTIMI I KAPITALIT THEMELTAR

Me vendim të Asamblese së Jashtezakonshme shoqëria mund të reduktojë kapitalin e shoqërise, me votim të Ortakut të vetem ose (ortakeve) votues prezente apo përfaqësuesve që përfaqësojnë të paktën 3/4 të kapitalit të shoqërise.

Reduktimi i kapitalit të shoqërise përballohet nga secili ortak në mënyrë proporcionale sipas kuotave që zoterojnë.

Asambleja mund të vendosë reduktimin e kapitalit të shoqërise, brenda kufijve të ligjit, qoftë edhe nëpërmjet ortakeve të vetem apo grupe ortakesh, aktiviteteve të shoqërise apo aksioneve e kuotave të shoqërive të tjera në të cilat shoqëria ben pjesë.

NENI 11

TRANSFERIMI I KUOTAVE

Kuotat mund të transferohen tek të tretet në total apo pjesë, pjesë, vetëm me aprovim të Ortakeve themelues të Shoqërise, ose të Asamblese së Jashtezakonshme të ortakeve që përfaqësojnë të paktën 3/4 e kapitalit të shoqërise.

Në çdo rast kuotat duhet të ofrohen paraprakisht ortakeve, vetëm në rast të dorëheqjes së tyre mund t'u shiten të treta, me kusht që transferimi të mos jetë me leverdi për blerësin në raport me ortaket.

KAPITULLI III

ASAMBLEA, ADMINISTRATORI, KONTROLLI

NENI 12

ASAMBLEJA E ORTAKEVE DHE TË DREJTAT

Organi vendimor i shoqërise është Administratori, ose Asambleja e Ortakeve.

Vendimet e saj me shumicë pengojnë ortaket që mungojnë apo të papajtuëshëm, përveç rasteve të të drejtës së tyre të kundërshtimit të ushtruar në rastë, afatë apo formë të parashikuara në ligj.

NENI 13

PJESEMARRJA NË ASAMBLE DHE E DREJTA E PJESEMARRJES NË VOTIM

E drejta e pjesëmarrjes në asamble rregullohet nga normat e ligjit.

Mund të marrin pjesë në asamble të gjithë ortaket e regjistruar në librin e ortakeve.

I takon Administratorit, ose (Kryetarit të asamblese) të konstatojë rregullshmerinë e delegimit dhe të drejtat e pjesëmarrësve në asamble.

Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në asamble, të bëjë prezente opinionin e tij dhe të shprehë aq vota sa ka kuota në kapitalin e derdhur të shoqërise.

Çdo ortak ka të drejtën e përfaqësimit nga një delegues me prokurë të posacme, i cili mund të shprehë të njëjten votë.

Ortaku nuk mund te jape asnje prokure per nje pjese te kapitalit te tij, nese voton personalisht per pjesen e mbetur.

NENI 14

THIRRJA E ASAMBLESE

Asambleja e zakonshme duhet te thirret te pakten nje here ne vit, brenda 6 (gjashte) muajve nga dita e mbylljes se bilancit te vitit ushtrimor, te relacioneve te administratorit ose te ekspertit kontabel, si dhe te inventarit.

Mund te thirret ne cdo moment nga administratori ose nga eksperti kontabel ose nga likuidatori kur e quajne te arsyshme, si dhe nga nje ose shume ortak qe perfaqesojne 1/10 e kapitalit te shoqerise.

Asambleja e ortakeve eshte e thirrur nen kujdesin e organit Administrativ, me ane te nje letre rekomande derguar ortakeve dhe ekspertit kontabel (n.q.s eshte emeruar) me vendbanimin marre nga libri i ortakeve, te pakten 15 (pesembedhjete) dite perpara mbledhjes.

Thirrja duhet te permbaje informacin per tipin e asamblese, problemet qe do te trajtohen, ditën dhe vendin e mbledhjes se pare dhe te dyte.

Asambleja do te thirret dhe do te mbahet rregullisht edhe pa respektuar formalitetet e mesiperme, dhe sikur te mos marrin pjese te gjithë ortakët ose perfaqesuesit e tyre, te gjithë administratorët dhe ekspertit kontabel (n.q.s eshte emeruar).

Sipas rendesise se vendimeve, asambleja mund te jete e zakonshme ose e jashtezakonshme.

NENI 15

ASAMBLEA E ZAKONSHME

Asambleja e zakonshme shqyrton dhe vendos per te gjitha ceshtjet qe nuk i perkasin Asamblese se jashtezakonshme sipas statutit ose ligjit, dhe ne vecanti:

- a) bilanci; relacionet e administratoreve dhe i ekspertit;
- b) ndarja e fitimit;
- c) emerimi dhe shkarkimin e administratoreve, ekspertit kontabel (nese ka).
- d) percakton shperblimet e administratoreve dhe te kryetareve, n.q.s ekzistojne.
- e) aprovon plane te prodhimit, te organizimit dhe te zhvillimit te aktivitetit.
- f) te tjera ceshtje ne kompetencat e saj ne baze te ligjit, te cilat i nenshtrohen me perpara nje ekzaminimi nga administratorët.

Asambleja e zakonshme rezulton e formuar rregullisht dhe mund te vendosi n.q.s eshte prezent ose perfaqeson 50% te kapitalit.

N.q.s mungon numri i ligjeruar, Asambleja duhet te thirret ne nje mbledhje te dyte dhe mund ti permbahet vendimit te shumices cilido qofte numri i ortakeve prezente ose te perfaqesuar dhe votuesve, pervec se ne rastin e emerimit dhe heqjes se administratoreve.

Ne kete rast ortaket prezent dhe votat e tyre ose te perfaqsesve te tyre duhet te kalojne 50% (pesedhjetepetqind) te kapitalit te shoqerise edhe ne mbledhjen e dyte.

Emerimi ne postet e tjera behet me shpallje ose me votim; ne hipotezen e fundit eshte e mjaftueshme, ne cdo rast, shumica relative e votave.

NENI 16

ASAMBLEA E JASHTEZAKONSHME

Asambleja e jashtezakonshme duhet te thirret kur duhen shqyrtuar ndryshime ne aktin kushtetues dhe ne statut, mbi emerimin dhe fuqite e likujdusesve, si dhe te tjera ceshtje te kompetences se saj ne baze te ligjit.

Asambleja e jashtezakonshme eshte rregullisht e formuar dhe si ne thirrjen e pare dhe te dyte, n.q.s perfaqson te pakten 3/4 (tretekatertat) e kapitalit dhe vendos me shumice votash te ortakeve prezente ose perfaqsesve dhe votuesve, qe perfaqsojne, si ne thirrjen e pare dhe te dyte, te pakten 3/4 (tretekaterten) e kapitalit.

Asambleja e jashtezakonshme vendos mbi ndryshimet e aktit kushtetues dhe statutit; mbi institucionalizimin e filialeve, degeve te ndermarrjes dhe te perfaqesive jashte shtetit; mbi rritjen ose uljen e kapitalit te shoqerise; te filialeve; mbi zhvillimin e aktiviteteve te reja ose mbi shpalljen e pjesmarrjeve; mbi traferimin e kuotave te kapitalit shoqeror; mbi emerimin ose heqjen e likujdusesve.

NENI 17

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Asambleja eshte e kryesuar nga Kryetari i Asamblese se Ortakeve ose nga dikush qe ka te drejtat, ose nga te tjere persona te zgjedhur nga vete Asambleja e Ortakeve; ne mungese te tyre, Asambleja zgjedh Kryetarin e Asamblese se Ortakeve.

Kryetari eshte i asistuar nga nje sekretar, i emeruar nga asambleja. Asistenca e sekretarit nuk eshte e nevojshme kur verbali i asamblese eshte i redaktuar nga nje Noter.

Vendimet e Asamblese duhet te pershkruhen ne verbal dhe duhet te nenshkruhen nga kryetari si dhe nga sekretari ose nga Noteri dhe duhet te kopjohen, per cdo rast ne Librin e Mbledhjeve dhe te Vendimeve te Asamblese.

Ne verbal duhet te futen, pas kerkeses se ortakeve, deklaratat e tyre.

Verbali i asamblese se jashtezakonshme, duhet te redaktohet nga nje Noter, dhe i hartuar nga kryetari i asamblese.

Asambleja e Ortakeve zgjedhi Administrator te shoqerise Zt. Veledin Spiro IDRIZAJ.

ADMINISTRATA DHE PERFAQSIMI

NENI 18

KESHILLI ADMINISTRATIV

Shoqeria administrohet nga nje Keshill Administrimi i perbere nga tre deri shtate persona, pa qene e nevojshme te jene ortake, ne konformitet me vendimet e asamblese.

Keshilli Administrativ zgjedh midis antareve te tij nje Kryetar, n.q.s nuk e ka zgjedhur asamblea dhe nje administrator te deleguar. Mund te zgjidhet edhe nje zevendes Kryetar qe do te zevendesoj Kryetarin ne rastet e mungesave ose te impenjimeve.

Keshilli Administrativ mund t'ia delegeje te drejtat e veta nje komiteti ekzekutiv te perbere nga anetaret e tij ose nje a me shume Administrator te Deleguar, duke percaktuar limitet e delegimit.

Perberesit e organit administrativ zgjasin ne detyre- sipas asaj qe ka vendosur asamblea ne aktin e emertimit me kohe te pacaktuar deri ne doreheqje, ose per nje periudhe e percaktuar nga vete asamblea.

Neqoftese shumica e administratoreve jep doreheqjen shfuqizohet gjithë Keshilli Administrativ dhe duhet te thirret asamblea e ortakeve per te zgjedhur Keshillin e ri.

NENI 19

EKSPERTET KONTABEL TE AUTORIZUAR

Neqoftese eshte e nevojshme ose kerkohet nga ligji, kontrolli i bilancit te vitit ushtrimor dhe te librave kontabile te shoqerise do t'i besohet nje eksperti kontabel te autorizuar, i emeruar per 3 (tre) vjet (dhe te rizgjedhshem) nga shumica e ortakeve qe perfaqesojne me shume se 50% (pesedhete perqind) te kapitalit.

Eksperti mund te hiqet me te njejtat rregulla si ne emerim, n.q.s gjenden gabime ne punen e tij ose kur gjykohet jo i pershtatshem per te kryer detyrat e ngarkuara.

NENI 20

SHPERBLIMET E ADMINISTRATOREVE

Perberesve te organit administrativ u perket nje shperblim vjetor, i vendosur nga asambleja, i llogaritur me perqindje mbi aktivet e bilancit sipas peshes se zerave, si dhe me rimbursimin e shpenzimeve te bera si rrjedhim i ushtrimit te funksioneve te tyre.

NENI 21

THIRRJA E KESHILLIT ADMINISTRATIV

Kryetari i Asambles se Ortakeve ose kush e zevendeson, therret, si ne qendren e shoqerise, edhe ne vende te tjera, Keshillin Administrativ ne kushtet e parashikuara nga ligji ose ne cdo rast qe e quan te arshyshme per interesin e shoqerise, me letra te rekomanduara qe u dergohen Keshilltareve, te pakten 5 (pese) dite perpara dites se fiksuar per mbledhje.

Ne rast urgjence thirrja mund te behet me telegram ose me fax edhe nje dite perpara dites se fiksuar per mbledhje.

NENI 22

KUORUMI I KESHILLIT ADMINISTRATIV

Per vlefshmerine e vendim-marrjes se Keshillit Administrativ eshte e nevojshme prezenca e shumices se Administratoreve ne detyre.

Vendimet merren nga maxhoranca absolute e pjesmarresve.

Ne rast votimi te barabarte vlen vota e atij qe drejton mbledhjen. Verbalet e mbledhjeve te Keshillit Administrativ firmosen nga Kryetari dhe nga sekretari dhe duhet te ruhen kopjet e tyre ne librin e mbledhjeve dhe vendimeve te Keshillit Administrativ.

NENI 23

FUQITE E ORGANIT ADMINISTRATIV

Keshilli eshte i veshur me te gjitha fuqite per administrimin e shoqerise. Mund te kryej cfaredo akti qe e quan te nevojshem per te arritur qellimin e shoqerise, si persa i perket administrimit te zakonshem, ashtu dhe te jashtezakonshem, asgje e ndaluar dhe asgje e perjashtuar, pervec asaj te ligjit ose te statutit prezent qe i rezervohet kompetencave te asamblese.

Keshilli Administrativ mundet, brenda kufijve te ligjit, te delegoj atributet e tij duke vendosur kufijte e delegimit tek nje ose tek shume nga antaret e tij, ventualisht sipas emerimit te Administratorit/ve, Deleguarit/ve, duke u dhene atyre firmen e shoqerise, individualisht ose kolektivisht, si ata mendojne e te vendosin.

Keshilli percakton pagen e Adminstratoreve te Deleguar dhe te Adminstratoreve te veshur me detyra te vecanta neqoftese asamblea nuk e ka quajtur te nevojshme te marre masa.

Keshilli mund te emeroj Drejtorin e Pergjithshem, Drejtorin Administrativ, dhe Drejtoret e tjere, me forme individuale ose kolektive, dhe te vendosi per fuqite dhe attribute si ta shikoje te arsyshme per te miren e vazhdimesise se shoqerise si dhe te dergoje ne pergjithesi akte te percaktuara dhe kategori aktesh.

Emerimi i Drejtoreve, Zevendes Drejtoreve e tjere drejtues, me percakti i pagave dhe shperblimeve perkatese mund te delegohet nga Keshilli tek Kryetari apo zevendesuesi i tij, tek Administratori/ret, te Deleguarit dhe tek Drejtoret Administrative.

NENI 24

PERFAQESIMI

Administratori, apo zevendesuesi i tij ka perfaqesine e Shoqerise dhe firmen e shoqerise per te gjitha aktet qe hyjne ne objektin e shoqerise.

Administratori, apo zevendesesi i tij, perfaqeson shoqerine ne gjykate, ne menyre fakultative pa pasur nevojte per miratim nga Keshilli, te promovojte veprime gjyqesore te cdo grade te gjykimit, si dhe per gjykim te Revokimit apo te Kasacionit, te promovojte veprime dhe ankime perpara te gjitha gjykatave administrative, si dhe te nderhyje dhe rezistojte ne raste te veprimeve apo ankimeve ne interes te Shoqerise.

Administratori, apo zevendesesi i tij, mund te paraqese ne emer te shoqerise, denoncime apo padi ne qendar penale, mund te ndertojte ane penale ne gjykime penale dhe te leshojte mandat apo prokura per keto raste. Keshilli eshte i autorizuar te konfirmojte perfaqesimin perpara te treteve dhe ne gjykim persa i perket shoqerise tek Administratorret e deleguar, tek Drejtoret e Pergjithshem, tek Drejtoret e tjere ne menyre individuale apo kolektive, me te njejtat fuqi.

Te drejten e konfirmimit te perfaqesimit perpara te treteve te te drejtes se firmes tek Drejtoret individualisht apo kolektivisht, me te njejtat fuqi.

Te drejten e konfirmimit te perfaqesimit perpara te treteve tek Drejtoret mund te jepet dhe nga Keshilli tek Administratori apo tek zevendesesi i tij, tek administratoret e deleguar apo tek Drejtoret Ekzekutive.

NENI 25

KONTROLLI I BRENDSEHEM

Administrimi i shoqerise kontrollohet nga Keshilli Administrativ, apo nese eshte e detyrueshme nga ligji, emerohet nga Asambleja nje Kontrollor i brendshem, specialist i fushes se kontroll revizionit, i cili mund te qendroje ne kete detyre tre vjet dhe mund te jete i riemerueshem.

KAPITULLI V

USHTRIMI VJETOR I SHOQERISE, BILANCI VJETOR SHPERNDARJA E FITIMIT

NENI 26

USHTRIMI I SHOQERISE DHE BILANCI VJETOR

Ushtrimi vjetor i shoqerise mbyllet me 31 dhjetor te cdo viti.

Ne fund te cdo ushtrimi Organi Administrativ procedon me hartimin e bilancit me llogaritjen e fitimit dhe humbjes sipas normave te ligjit, duke e shoqeruar me nje relacion shtese per aktivitetin e shoqerise.

Cdo ortak ka te drejten te kete nga Organi Administrativ informacione mbi zhvillimin e puneve te shoqerise dhe te konsultohet me librat e shoqerise.

NENI 27

NDARJA E FITIMIT

Fitimet neto, qe rezultojne nga bilanci vjetor, reduktuar me 5% (pese perqind) te destinuar per rezerven ligjore, qe arrin deri ne 10 % te kapitalit te shoqerise, si edhe reduktimet eventuale te percaktuara nga Asambleja, shperndahen ndermjet ortakeve ne raport me kuotat e kapitalit qe zoteron secili.

Asambleja mund te vendose edhe terheqje te tjera speciale ne favor te rezervave te jashtezakonshme apo destinacione te tjera, apo rikthim te fondeve nga destinacionet e tyre - ne total apo pjeserisht - ne vitet e ardhshme.

Fitimi i mbetur qe asambleja ka vendosur ta shperndaje u dorezohet ortakeve ne raport me aksionet qe zoteron secili.

KAPITULLI VI

SHKRIRJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

NENI 28

SHKRIRJA

Shoqeria shkrihet me perfundimin e afatit te percaktuar ne Statut, apo perpara kesaj skadence ne rastet e parashikuara nga ligji apo me vendim te Asamblese se Jashtezakonshme te ortakeve.

NENI 29
LIKUJDIMI

Ne rastin e shkrirjes shoqeria i nenshtrohet likujdimit.

Per te drejtuar kete procedure Asamblea emerone nje apo disa likuidatore, te cilet paraqesin relacionin perfundimtar mbi gjendjen e aktivitetit dhe te pasivit te shoqerise, mbi operacionet e likujdimit dhe mbi afatet e nevojshme per te perfunduar likujdimin.

Ne perfundim te procedures se likujdimit, Asamblea vendos, me shumicen e ortakeve qe zoterojne me shume se 3/4 e pjeseve te kapitalit te shoqerise mbi bilancin perfundimtar financiar, mbi vleren e punes se kryer nga likujduesit dhe mbi perfundimin e punes se likujdimit.

Pas pagimit te kreditoreve, likujduesi shperndan te ardhurat perfundimtare per likujdim te ortakeve ne raport me kuotat qe zoterojne ne shoqeri.

NENI 30
TRANSFORMIMI I SHOQERISE

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar mund te kthehet ne shoqeri kolektive apo akomodite vetem me aprovim unanimit te ortakeve, dhe mund te transformohet ne shoqeri aksionere me aprovim te shumices se ortakeve qe zoterojne mbi 3/4 (tre te katertat) e kuotave te kapitalit te shoqerise.

NENI 31
ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin nga interpretimi, zbatimimi dhe zgjidhja e ketij statuti dhe te aktit te themelimit te shoqerise, si edhe ne pergjithesi te gjitha mosmarreveshjet midis ortakeve (pervec atyre qe u perkasin maredhenieve personale jashte shoqerise) apo midis nje apo disa ortakeve dhe shoqerise, duhet se pari te zgjidhen me mirekuptim midis paleve.

Ne rast mungese te mirekuptimit, zgjidhja mund t'i besohet gjykates shqiptare.

NENI 32
DISPOZITA PERFUNDIMTARE

Per gjithshka qe nuk eshte paraqitur ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e Kodit Civil dhe te ligjislacionit per shoqerite tregtare.

NENI 33
GJUHA

Ky statut eshte perpiluar ne Tirane me 12.12.2006, ne kater kopje origjinale, ne gjuhen shqipe.



NENI 34


Ky statut u lexua, firmos dhe u nenshkrua nga ortaket e shoqerise
"EUROCLIMA" Shpk.



ORTAKU I VETEM THEMELUES I SHOERISE
"EUROCLIMA" Shpk

Veledin Spiro IDRIZAJ

Tirane, me 04.04.2007

Veledin Idrizi




REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
DHOMA E NOTEREVE
TIRANE




Nr.1272.Rep./Nr.130.Kol.
Tirane, me 05.04.2007

VERTETIM:

Ne Tirane, sot me daten 05.04.2007 (dymijeeshtate), para meje Noterit Publik Boris M.SKENDI, me Seli Rruga "Reshit COLLAKU", Pall. "Shallvareve", Nr.4 Tirane, u paraqit personalisht dhe me kerkoi vertetimin noterial te nenshkrimit te tij ne kete Statut, perpiluar jashte kesaj Zyre Noteriale, per themelimin e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "EUROCLIMA" Shpk.

Veledin IDRIZAJ, i biri i Spiros dhe i Hamidese, me kombesi e shtetesi Shqiptare, lindur me 20.03.1968 ne Kuc, Vlore dhe me banim: ne Bexulle Tirane, identifikuar nepermjet Pasaportes Nr.1430030 date 02.09.1999, madhor, me zotesi te plote juridike perte vepruar.

Sa me lart mbasi u binda per identitetet e tij nepermjet dokumenteve individuale qe mban me vete si dhe per nenshkrimin e vullnetshem sipas deklarimit te tij ne kete Zyre Noteriale, me pas une Noteri Publik e vertetoj ate sipas kompetencave qe me jep Ligji Nr.7829 date 01.06.1994 "Per Noterine".





REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
DHOMA E NOTERVE
TIRANE



Nr.1273/Rep
Tirane me 05.04.2007



PROCESVERBAL PER DEPOZITE ;


Ne Tirane, sot me daten 05.04.2007 (dymijeeshtate), para meje Noterit Publik Boris M.SKENDI, me Seli Rruga "Reshit COLLAKU", Pall. "Shallvareve", Nr.4 Tirane u paraqit personalisht:

Veledin IDRIZAJ, i biri i Spiros dhe i Hamidese, me kombesi e shtetesi Shqiptare, lindur me 20.03.1968 ne Kuc, Vlore dhe me banim: ne Bexulle, Tirane, identifikuar nepermjet Pasaportes Nr.1430030 date 02.09.1999, madhor, me zotesi te plote juridike perte vepruar, dhe me kerkoi depozitim e shumes prej 100.000 leke (njqindemijeleke), si fond Themeltar te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "EUROCLIMA" Shpk.

Depozitimi i ketij fondi si kapital themeltar i "EUROCLIMA" Shpk u be ne baze te Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare" nenet 40 dhe 80.

DEPOZITUESI
"EUROCLIMA" Shpk

Veledin Idrizaj
Veledin Spiro IDRIZAJ



7: H. Beolw
dt. 10.04.2007

10 APR 2007



KERKESE

GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR

TIRANE

KERKUESI:

Veledin IDRIZAJ, i biri i Spiros dhe i Hamidese, me kombesi e shtetesi Shqiptare, lindur me 20.03.1968 ne Kuc, Vlore dhe me banim: ne Bexulle Tirane, identifikuar nepermjet Pasaportes Nr.1430030 date 02.09.1999, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar.

OBJEKTI:

Rregjistrim prane Rregjistrin Tregetar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar te "EUROCLIMA" Shpk.

Une Veledin Spiro IDRIZAJ, me cilesine e Ortakut te vetem themelues, ne baze te Aktit te Themelimit e Statutit te perpiluar posacerisht kam themeluar Shoqerine "EUROCLIMA" Shpk me Objekt:

Ushtrimin e tregetise me shumice e pakice te artikujve te ndryshem industriale, pajise e materiale te ndryshme hidraulike e elektrike, dhe ne pergjithesi cdo aktivitet plotesues.

Import dhe eksport mallra e paisje te te gjitha llojeve, makineri e paisje, si dhe aktivitetin e shperndarjes e te pedorimit te tyre, per vete Shoqerine dhe per te tjere.

Te kryeje furnizime te impianteve dhe te paisjeve teknike per aktivite qe operojne dhe qe kane lidhje me ato te shoqerise.

Shoqeria mund te kryej te gjitha operacionet industriale, tregtare, prodhuese, ndertuese, ndertime objekte te ndryshme industriale e civile, prodhime inertesh e materiale ndertimi, financime, qe Administratori e quan te nevojshem per arritjen e qellimit te shoqerise, si dhe cdo objekt tjetet qe nuk bie ne kundershtrim me ligjin.

Shqeria do te kryej veprimatri ne fushen hotelerise, turizemit, ushqimit social, administrim i internet cafeze, perfshire administrimin e aktiviteve te lidhura me te si: bar, sherbime fotokopje, shitje te vogla kancelerie dhe materialeve te konsumit e aktivite te tjera te ketij lloji.

Te hyje ne veprimtari afariste qe con ne realizimin e synimeve te saj.

Shoqeria mund te kryej drejtperdrejt apo indirekt, brenda dispozitave ligjore, pjesemarrje ne Shoqeri te tjera, te zhvilloje cdo lloj aktiviteti, qe lidhet dhe ne menyre indirekte me qellimet e Shoqerise e qe vleresohen te dobishme per arritjen e tyre.

Për këtë qëllim shoqëria ka të drejtë:

Të importojë, eksportojë dhe tregtojë makineri dhe pajisje e produkte te ndryshme industriale e bujqesore.

Ti japë punë me porosi te tretëve për sherbime të ndryshme.

Te ofroje dhe te kryeje sherbime e konsulenca ne fushen teknike dhe tregtare.

Të organizojë kurse formimi dhe specializimi.

Shoqeria ka seline e saj ne Bexulle, Tirane.

Qendra fiskale e shoqerine, eshte selia e shoqerise.

Kohezgjatja e Shoqerise eshte pa afat.

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100.000 (njqindmije) leke, i ndare ne 100 (njqind) kuota, me nje vlere 1000 lek secila, me numer serie nga 1 deri ne 100.

Derdhja e kuotave eshte bere totalisht nga Ortaku i vetem themelues i Shoqerise Zoti Veledin Spiro IDRIZAJ ne masen 100.000 (Njqindemije) Lek, qe i perkasin 100 kuota, nga Nr.1 deri Nr.100 te serise, qe korespondojne me 100 % te kapitalit te shoqerise.

Administrator i Shoqerise "EUROCLIMA" Shpk eshte Zoti Veledin Spiro IDRIZAJ.

KERKUESI:
Veledin Spiro IDRIZAJ

Veledin Idrizi
[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
DHOMA E NOTEREVE
TIRANE

Nr.1270.Rep.
Tiranë, më 05.04.2007



VERTETIM:

Ne Tirane, sot me daten 05.04.2007 (dymijeeshtate), para meje Noterit Publik Boris M.SKENDI, me Seli Rruga "Reshit COLLAKU", Pall. "Shallvareve", Nr.4 Tirane, u paraqit personalisht dhe me kerkoi vertetimin noterial te nenshkrimit te tij ne kete kerkese perpiluar jashte kesaj Zyre Noteriale, drejtuar Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane per themelimin e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "EUROCLIMA" Shpk.

Veledin IDRIZAJ, i biri i Spiros dhe i Hamidese, me kombesi e shtetesi Shqiptare, lindur me 20.03.1968 ne Kuc, Vlore dhe me banim: ne Bexulle, Tirane, identifikuar nepermjet Pasaportes Nr.1430030 date 02.09.1999, madhor, me zotesi te plote juridike perte vepruar.

Sa me lart mbasi u binda per identitetet e tij nepermjet dokumenteve individuale qe mban me vete si dhe per nenshkrimin e vullnetshem sipas deklarimit te tij ne kete Zyre Noteriale, me pas une Noteri Publik e vertetoj ate sipas kompetencave qe me jep Ligji Nr.7829 date 01.06.1994 "Per Noterine".

